



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 17.05.2024 ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit penal Nr.82, të vitit 2021, me të pandehur **Rajmonda Balilaj, Anisa Petani, Shkëlqim Beqiraj, Enirjada Rizaj**, të akuzuar për veprën penale të “*Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, e kryer në bashkëpunim, dy herë”, parashikuar nga neni 258-25 i K.Penal (përpara ndryshimeve të bëra me ligjin Nr.43/2021), si dhe të pandehurit **Vangjel Nushi, Boreta Murati dhe Arben Manoku**, akuzuar për veprën penale të “*Falsifikimi i dokumenteve*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal.
2. Në përfundim të gjykimit Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, me Vendimin Nr. 82, datë 28.06.2024 vendosi:
 1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
 2. Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me Nr.82, të vitit 2021, në ngarkim të të pandehurve:
 - **Rajmonda Balilaj, Anisa Petani, Shkëlqim Beqiraj, Enirjada Rizaj**, të cilët akuzohen për veprën penale “*Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, e kryer në bashkëpunim, dy herë, parashikuar nga neni 258-25 i Kodit Penal (përpara ndryshimeve të bëra me ligjin Nr.43/2021).
 - **Vangjel Nushi, Boreta Murati, Arben Manoku**, të cilët akuzohen për veprën penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.
 - Dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për t’u hedhur në short.
 3. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

Tiranë, më datë 28.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar